

## Organika e Pushtetit Gjyqësor

Numri i punonjësve për Pushtetit Gjyqësor miratohet me Ligjin e Buxhetit vjetor, mbi bazën e projekt-buxhetit të propozuar nga Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor. Organika e propozuar është finalizim i konsultimeve dhe vendimeve të institucioneve si Gjykatat, Bordi Drejtues i ZABGJ-së, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Ministria e Drejtësisë.

Numri i punonjësve të Gjykatës së Lartë rregullohet me Ligjin e Gjykatës së Lartë nr.8588, datë 15.03.2000 *“Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar me Ligjin nr.151/2013 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.8588, datë 15.03.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë”*

Numri i Gjyqtarëve të dy niveleve rregullohet me Dekretin e Presidentit nr.7818, datë 16.11.2012 *“Për caktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë të shkallës së parë, të apelit dhe të gjykatave administrative si dhe caktimin e kompetencave tokësore dhe selisë qendrore të gjykatave administrative”*.

Numri i punonjësve të ZABGJ-së rregullohet me Ligjin nr.8363, 01.07.1998 *“Për krijimin e Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor”*.

Struktura dhe numri i punonjësve të administratës së dy niveleve përcaktuar me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë, në zbatim të Ligjit nr.109/2013 *“Për administratën Gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”*

Për vitin 2014 Pushtetit Gjyqësor, me Ligjin e Buxhetit nr.185/2013 *“Për buxhetin e vitit 2014”*, ju akorduan 1309 punonjës

Nr.	Institucioni	Numri i miratuar	Gjyqtar	administratë
1	Gjykata e Lartë	131	19	112
2	Gjykatat e Apeleve	226	89	137
3	Gjykatat e rretheve gjyqësore	769	251	518
4	Gjykatat administrative	163	43	120
	<b>totali</b>	<b>1289</b>	<b>402</b>	<b>887</b>
5	ZABGJ	20		20
	<b>totali</b>	<b>1309</b>	<b>402</b>	<b>907</b>

### ***Stafi i gjyqtarëve***

Numri i Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, sipas Ligjit nr.15/2013, është 19 gjyqtarë.

Numri i gjyqtarëve për shkallën e parë dhe të dytë, i miratuar me Dekretin e Presidentit nr.7818/2012 është 383 gjyqtarë.

Numri total i gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë është 402 gjyqtarë.

<b>Nr.</b>	<b>Institucioni</b>	<b>Gjyqtar</b>
1	Gjykata e Lartë	19
2.	Gjykata	383
	totali	402